

05.09.2008

## WUS-Austria financon 5 projekte në Universitetin e Prishtinës

13:34 ET Prishtinë (KosovaLive)



Universiteti i Prishtinës (UP) mori të premtën mbështetje nga shteti austriak për pesë projekte në vlerë prej 833 mijë euro, projekte këto që vlerësohen se do të ofrojnë mbështetje përmbajtjesore për procesin reformues në arsimin e lartë në Kosovë.

Kjo u bë e ditur me rastin e lansimit të projektit WUS– Austria, në të cilën pjesëmarrës ishin dekanët e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe financuesit e projekteve.

Bud Dedaj, koordinator i programeve të WUS-Austria për Kosovë, tha se pesë projektet e planifikuara për Universitetin e Prishtinës janë të projektuara për tri vitet e ardhshme dhe shprehin ndihmën që Austria është duke dhënë përmes Agjencisë austriake të zhvillimit për arsimin e lartë në Kosovë.

“Fondi i përgjithshëm për këto pesë projekte është rreth 833 mijë euro. Kjo do të thotë mbështetje përmbajtjesore për procesin reformues dhe sa më shpejt të bëhemi pjesë e arsimit të lartë evropian”, tha Dedaj.

Në kuadër të këtyre pesë projekteve përfshihet: zhvillimi i tre master programeve të reja në Fakultetin Juridik, një në Fakultetin Filozofik dhe në një në Fakultetin e Mjekësisë.

Projekti i dytë është projekti i zhvillimit të “kurrikulit plus”, në kuadër të së cilës do të mbështeten profesorët që zbatojnë lëndët e reja mësimore, apo aplikojnë metodologji të re shkencore në lëndët ekzistuese.

Sipas Dedajt, profesorët do të mbështeten financiarisht për honorarët, mbështeten për vizita studimore jashtë dhe fakultetet do të kenë mundësi të blerjes së pajisjeve të nevojshme në vlerë deri në 10 mijë euro.

Projekti i tretë vlerësohet të jetë projekti “zhvillimit të trurit”, i cili tani më është i njohur në Kosovë, ku 50 profesorë të lëmenjve të caktuar do të vijnë dhe do të mbajnë cikël të ligjëratave në Universitetin e Prishtinës.

Profesorët e huaj kanë mundësi të vijnë për hulumtime shkencore në Kosovë dhe po ashtu do të ketë mundësi të jenë mentorë për ta udhëhequr punën e ndonjë kandidati.

Projekti i katër përfshin punësimin e një zyrtari në Rektorat që do të kujdeset për reformë dhe zhvillimin e kurrikulit në UP, ndërsa programi i pestë është “Balkan Case Challenge”, projekt që tani ka një vit që është zbatuar.

Dedaj tha se këto projektet përveç mbështetjes financiare, ndihmojnë edhe në rrjetëzimin, lidhjen me universitetet evropiane, meqenëse profesorët mund të shkojnë jashtë në kohëzgjatje prej një javë dhe përmes qëndrimit javor të arrijnë të mbledhin materiale të mjaftueshme për të zhvilluar lëndën e re mësimore.

/b.salihu/ <<<<